Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**15.08.2023**	**25.08.2023**	**2023/0584**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 14.08.2023, OE “" AS Tech " SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0584, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “" AS Tech " SH.P.K.”- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi montimi dhe leshimi ne pune i kondicionereve ne ndertesat Qeveritare” me nr. të prokurimit: "214-23-1198-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0584 i dt:14.08.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

ParasNeni7 BarazianëTrajtim/Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe

jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

1. Autoritetikontraktues dorëzuarose: dot’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që

ka

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; Neni7 - BarazianëTrajtim/JoDiskriminimi

Neni59 Ekzaminimi,VlerësimidheKrahasimiiTenderëve

1 . Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin,

vlerësimin dhe krahasimin e ofertave.

Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për

vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do

ta nxjerrë legjislacion dytësor lidhur me këtë çështje.

2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrimtë kërkojë nga një tenderues që të sigurojë

një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij,në mënyrë që të bëhet

ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë

aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues.htrojme kete Ankese kunder Vendimit te AK-se te dates 28.07.2023 ku AK bene

anulimin e tenderti si pale e pakenaqur me kete vendim parashtrojme kerkesen per

rishqyrtim lidhur me dy pretendime:

Pretendimi1.

AK ka bere shkelje te nenit 59 Neni59 Ekzaminimi,Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

dhe nenit 60 Kriteretpër DhënieneKontratës duke mos e vleresuar si duhet oferten e As

tech shpk si oferten e vetme te pergjegjshme. Oferten tone e keni eleminuar me arsyetimin

se katallogu i ofruar nuk permban te dhena te mjaftueshme, kjo fjali e shkurter permban

dy gabime permbajtesore: Nen 1- nese katallogu nuk permban te dhena te mjaftueshme

AK ka pasur mundesi te kerkoje ende sqarime ose te hulumtoje vete tregun dhe kete brend

siq e lejon edhe ligji i prokurimit, sepse ne nuk duhet te eleminohemi per nje katallog qe

nuk permban te dhena te mjaftueshem ndersa ai katallog prodhohet jashte shtetit. Nen 2 -

Nese katallogu nuk permban te dhena te mjaftueshem sdo te thote qe nuk i permbush

specifikimet teknike siq jeni shprehur se rrjedhimisht nuk i permbush ato. E vetmi devijim

qe e keni permend ne leter standare eshte nje kapacitet e zhurmes se klimes, se ne katallog

ka nje devijim te vogel. Edhe vete ligji i prokurimit i lejon devijimet e vogla dhe qe nuk

kan ndikim ne aspektin material ose permbajtesor. Nese Ak eshte ndalur per ta refuzuar

nje oferte sepse nivelin e zhurmes e ka me nje devijim te vogel kjo do te thot qe ketu nuk

kemi te bejme ne treg te lire, por AK paska kerkuar produkte te nje brendi ose furnizuesi te caktuar dhe te gjithe te tjeret qenkan te papranueshem, dmth ju kerkon produkt identik per nje kontrate te klimatizimit qe nuk eshte aq e ndjeshme ose specifke qe te mos funksionoj ne implementim te kontrates ai detaj i vogel.

Pretendimi 2.

Ne vendim te dates 28.07.2023 Ak ka eleminuar oferten e OE Infinit me arsyetimin se OE ma bere manipulim te katallogut, pajtohemi me kete sepse kemi qene ne ata te cilet kemi bere kerkese per rishqyrtim lidhur me kete ne Vendimin e pare te AK-se ne muajin maj. Por nuk pajtohemi me ate qe AK qeshtjen e manipulimit e konsideron vete nje arsye pse oferta e Infinit nuk eshte shperblyer dhe nuk na jep deshmi se ka inicuar kerkese per respektim te nenit 99.2 te LPP-se rrjedhimisht propozimin per liste te zeze per OE en fjale drejtuar OSHP-se. AK e veren nje manipulim qe OE per te ju pershtatur specifikave te Dosjes i ka bere vete katallogun dhe specifikat por kjo gje nuk duhet te lejohet sepse manipulimi eshte rreptesisht i ndalur ne prokurim. Zyrtari pergjegjes i prokurimit duhet ta kete obligim qe cdo padrejtesi qe veren gjate procesit te raportoj ashti siq e thot edhe ligji i prokurimit. Kerkojme rivleresim te lendes, shperblim te ofertes tone em kontarte dhe deshmi se keni inicuar kerkese drejtuar OSHP-se per respektim te nenit 99.2.

Lidhur me pretendimin nr. 2, per aq sa e vleresuam vendimin e Ak ne kerkesen tone per rishqyrtim pame qe AK nuk e ka shqyrtuar kete pretendim.

Perfundimisht kerkojme shqyyrtim te dz pretendimeve tona nga OSHP, krhim te lendes ne rivleresim dhe rrjedhimisht vleresimin e drejte te ofertes toen si te vetme te pergjegjshme.

KRITERET PËR VLERËSIM

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1	**Llojet e klimave (Furnizim, montim dhe lëshim në punë)**		
1.1	Furnizimi, montimi i klimave(njësi e jashtme dhe e brendshme, gypat, mbajtëset e klimave, mbushja me refrigerant) me kapacitet 9000BTU INVERTER me të dhëna: - Freon R32 - Ftohja deri në -18°C - Ngrohja deri në -30°C - Klasi i energjisë: A+++ - Kapacitet i ftohjes 3,1 kW - Kapaciteti i ngrohjes 3.2 kW - SEER 7.5 W/W SCOP 5,30 W/W - Niveli i zhurmës 50 db (A) - Garancion 5 Vite	copë	14
1.2	Furnizimi, montimi i klimave(njësi e jashtme dhe e brendshme, gypat, mbajtëset e klimave, mbushja me refrigerant) me kapacitet 1200BTU INVERTER me të dhëna: - Freon R32 - Ftohja deri në -18°C - Ngrohja deri në -30°C - Klasi i energjisë: A+++ - Kapacitet i ftohjes 3,53 kW - Kapaciteti i ngrohjes 4,20 kW - SEER 8,50 W/W SCOP 5,50 W/W - Niveli i zhurmës 44/54 db (A) - Garancion 5 Vite	copë	12

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(Njoftimi mbi vendimin e AK)

Adresa e tenderuesit "AS Tech" SH.P.K. TRINGË SMAJLI, PRISHTINË

Nr. i prokurimit [6]	**214-23-1198-1-2-1**

Titulli: Furnizimi montimi dhe lëshimi në punë i kondicionerëve në ndërtesat Qeveritare

I/e nderuar(a) *[Z/Znj]/* _____

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi juaj është i papërgjegjshëm:

Nuk keni dorëzuar dëshmi siç është kërkuar në faqet 9 të Dosjes së tenderit Njoftimit për kontratë (Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale):

ARSYETIM

Komisioni i rivlerësimit në bazë të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka konstatuar se ne ofertën tuaj nuk keni ofruar katalog fare, siç është kërkuar ne dosje te tenderit, bazuar në nenin 59 dhe 72 të LPP-së AK me datën 04.07.2023 ka kërkuar dëshmi katalogun me specifikim teknik. për produktet e ofruar, mirëpo dëshmia e ofruar nga ju nuk e përmbush kërkesat e specifikimit teknik konkretisht te niveli i zhurmës: është kërkuar qe niveli i zhurmës te jetë 50 dcb, ne katalogun e ofruar 07.07.2023 është ofruar 53 Dcb. Meqenëse ka pasur paqartësi se katalogu i ofruar ka qene i përgjithësuar , AK me datën 19.07.2023 ka dërguar edhe një letër standarde ku ka kërkuar nga ju qe te jetë me i saktë se cilat produkte konkretisht ofrohen (*ju lutem qe produktet qe ofroni te nënvizohen qe te kemi me te qartë se çka po ofroni*) me datën 24.07.2023 kemi pranuar katalogun me një shkrese përcjellëse me te cilën referohet tipit te klimave Bruno . Pas shikimit dhe analizimit te katalogut te fundit te ofruar, kemi vërejtur se modeli i ofruar , nuk ka informata te mjaftueshme lidhur me specifikat teknike te produkteve te cilat janë kërkuar me dosjen e tenderit dhe rrjedhimisht nuk plotësojnë kërkesat ne dosjen e tenderit me te cilën është kërkuar katalog me specifikim detaj siç është kërkuar ne ANEKSIN 1.

_____

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" AS Tech " SH.P.K.**

Pretendimi nr.1

Pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës 584/23 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti nuk ka ofruar produktin në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit/specifikacionit teknik, konkretisht në pozicionin 1.1 është kërkuar klima me nivel të zhurmës 50 (db)A, ndërsa sipas AK-së OE ankues ka ofruar klimë me nivel të zhurmës 53 decibel.

OE ankues përmes ankesës së parashtruar në OSHP pretendon se ky dallim duhet të llogaritet si devijim i vogël dhe se vete ligji i prokurimit i lejon devijimet e vogla dhe qe nuk kanë ndikim ne aspektin material ose përmbajtësor.

Në rastin konkret mendimi ekspertit është se tejkalimi i nivelit të zhurmës së caktuar nga AK, nuk mund të thuhet se nuk përbën devijim nga karakteristikat e parashtruar nga AK, ashtu siq parashihet me nenin 59 par.4, pika (ii) të LPP-së, pasi varësisht nga vendi/hapësira se ku do të vendosen këto klima, niveli më i lartë i zhurmës mund të paraqes pengesë për personat që punojnë në ato hapësira.

Në parim pajtohemi me OE ankues se dallimi në nivelin e zhurmës 53 decibel i ofruar, përkundër 50 decibel të kërkuar është dallim i vogël, megjithatë konsiderojmë se klasifikimi si "devijim të vogël" në rastin konkret duhet të jetë në diskrecion të AK-së, pasi në cilësi të ekspertit shqyrtues nuk mund të pohojmë se dallimi për 3 decibel nuk do të paraqes pengesa për AK-në, përderisa AK e konstaton dhe insiston në të kundërtën.

Nëse OE ankues pretendon se një kërkesë e tillë (niveli zhurmës) është kërkesë diskriminuese për ndonjë OE apo kërkesë favorizuese për OE tjetër, i njëjti këtë pretendim është dashur ta ngrin pranë AK-së të paktën 5 ditë para hapjes së ofertave në pajtim me dispozitat e nenin 108/A të LPP-së.

Sa i përket pretendimit ankimorë për arsye të eliminimit ku sipas AK-së katalogu i ofruar nuk përmban të dhënat e nevojshme, konsiderojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar në kuptim të asaj se AK ka mund të kërkoj informata shtesë nga OE apo edhe nga vet prodhuesi, mirëpo përderisa tanimë është konfirmuar se njëri nga produktet e ofruara nga OE është në kundërshtim me specifikacion teknik, kthimi i lëndës në rivlerësim me qëllim për tu kërkuar sqarime shtesë nuk do ndryshonte faktet tanimë të konfirmuara (tejkalimi nivelit të zhurmës) dhe nuk do sjell ndryshim në rezultat përfundimtar.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, i rekomandojmë panelit shqyrtues që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" AS Tech " SH.P.K.**

Ilir Halili

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA